



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KËSHILLI I MINISTRAVE KËSHILLI KOMBËTAR I TERRITORIT

PROJEKT - VENDIM

Nr. 03, datë 20.06.2018

PËR

MIRATIMIN E NISMËS PËR HARTIMIN E PLANIT KOMBËTAR SEKTORIAL NË FUSHËN E TURIZMIT

Në mbështetje të neneve 7, 10, 17 dhe 25 të Ligjit Nr. 107/2014, datë 31.07.2014 “Për Planifikimin dhe Zhvillimin e Territorit”, i ndryshuar, VKM-së Nr. 881, datë 14.12.2016 “Për miratimin Planit të Përgjithshëm Kombëtar të Territorit”, VKM-së Nr. 686, datë 22.11.2017 “Për miratimin e Rregullore së Planifikimit të Territorit”, VKM-së Nr. 519, datë 20.09.2017 “Për përcaktimin e përbërjes së Këshillit Kombëtar të Territorit”, i ndryshuar, me propozim të Ministrisë së Turizmit dhe Mjedisit, Këshilli Kombëtar i Territorit,

VENDOSI:

- 1 Miratimin e Nismës për hartimin e Planit Kombëtar Sektorial (PKS) në fushën e Turizmit, ku do të përcaktohen zonat me përparësi zhvillimin e turizmit.
- 2 Dokumenti i plotë i Nismës për hartimin e Planit Kombëtar Sektorial në fushën e turizmit, përmban:
 - a) analizën, e cila përcakton qëllimin dhe nevojën për hartim ose rishqyrtim të dokumentit të planifikimit;
 - b) kufijtë e territorit që mbulon dokumenti i planifikimit;
 - c) listën e dokumenteve përbërëse të PKS-së;
 - ç) ekspertët (fushat e ekspertizës) që do të përbëjnë grupin e punës, hartues të PKS-së;
 - d) përcaktime për procesin e bashkërendimit, këshillimit e takimeve publike dhe afatet përkatëse;
 - dh) planin e veprimeve për hartimin e dokumentit të PKS-së.

- 3 Fillimin e procedurës për ngritjen e grupit të punës me ekspertë me qëllim hartimin e Planit Kombëtar Sektorial në fushën e turizimit.
- 4 Ministria e Turizmit dhe Mjedisit dhe Agjencia Kombëtare e Planifikimit të Territorit të drejtojnë punën për hartimin e Planit Kombëtar Sektorial në fushën e turizimit.
- 5 Ngarkohet Ministria e Turizmit dhe Mjedisit dhe Agjencia Kombëtare e Planifikimit të Territorit për zbatimin e këtij Vendimi.
- 6 Ky Vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI

EDI RAMA

MINISTËR I LINJËS

MINISTËR I TURIZMIT DHE MJEDISIT

BLENDI KLOSI

ANËTAR / SEKRETAR I KKT

DREJTOR I AGJENCISË SË ZHVILLIMIT TË TERRITORIT

LEDIA TOTA

DRAFT